E paditura- AKP thekson se në bazë të nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit parashihet që tre pagat e papaguara të fundit të punonjësve janë kërkesa preferenciale dhe si të tilla mbajnë prioritet më të lartë. Megjithatë, kjo dispozitë nuk i jep të drejtë të gjithë punonjësve për tri paga, por i jep prioritet tre pagave të fundit të cilat eventualisht kanë mbetur të papaguara prej numrit të pagave të cilat NSH pretendohet se nuk i ka paguar punonjësve. Sidoqoftë, kërkesa për paga të papaguara duhet të mbështetet me dëshmi në mbështetje të ekzistencës së një obligimi të tillë. Neni më lart nuk i jep automatikisht të drejtë të gjithë punonjësve për këto tri paga. Me tej e paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *“...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. Tutje e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”*. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur NSH-ja pretendohet se nuk e ka përmbushur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës që është me se voni 3 vjet nga koha kur parashtruesi pretendohet se nuk e ka marr rrogën, nuk ka dëshmi se parashtruesi e ka parashtruar këtë kërkesë në gjykate apo autoritet tjetër kompetent, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e pavlefshme.

Për vendimin: PRN046-0434

E paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *“...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. E paditura pohoi se nuk ka dëshmi se parashtruesi e ka parashtruar këtë kërkesë në gjykate apo autoritet tjetër kompetente që nga kur rroga pretendohet se ka mbetur papaguar. Me tej e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të*

punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet". Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur NSH-ja pretendohet se nuk e ka përmbushur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës që është me se voni 3 vjet nga Marsi i vitit 2005, kur parashtruesi pretendohet se nuk e ka marr rrogën, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e parashkruar dhe si e tillë është refuzuar si e pavlefshme.

Për vendimin: PRN046-0369

E paditura- AKP thekson se në bazë të nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit parashihet që tre pagat e papaguara të fundit të punonjësve janë kërkesa preferenciale dhe si të tilla mbajnë prioritet më të lartë. Megjithatë, kjo dispozitë nuk i jep të drejtë të gjithë punonjësve për tri paga, por i jep prioritet tre pagave të fundit të cilat eventualisht kanë mbetur të papaguara prej numrit të pagave të cilat NSH pretendohet se nuk i ka paguar punonjësve. Sidoqoftë, kërkesa për paga të papaguara duhet të mbështetet me dëshmi në mbështetje të ekzistencës së një obligimi të tillë. Neni më lart nuk i jep automatikisht të drejtë të gjithë punonjësve për këto tri paga. Me tej e paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *"...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme"*. Tutje e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *"pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet"*. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur NSH-ja pretendohet se nuk e ka përmbushur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës që është me se voni 3 vjet nga koha kur parashtruesi pretendohet se nuk e ka marr rrogën e fundit, nuk ka dëshmi se parashtruesi e ka parashtruar këtë kërkesë në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e pavlefshme.

Për vendimet: PRN046-0368 dhe PRN046-0423

E paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *"...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme"*. E paditura pohoi se nuk ka dëshmi se parashtruesi e ka parashtruar këtë kërkesë në gjykatë apo autoritet tjetër kompetente që nga kur rroga pretendohet se ka mbetur papaguar. Me tej e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *"pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet"*. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur NSH-ja pretendohet se nuk e ka përmbushur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës që është me se voni 3 vjet nga kur parashtruesi pretendohet se nuk e ka marr rrogën, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e parashkruar dhe si e tillë është refuzuar si e pavlefshme.

Për vendimin: PRN046-0541

E paditura- AKP thekson se sipas arkivit te privatizimit, privatizimi i NSH “Fan Zahir Pajaziti” Podujevë është kryer me 24 Mars 2006, dhe te gjitha marrëdhëniet e punës te te gjithë punonjësve të NSH-së kanë përfunduar ne Mars te vitit 2006. Me tej thekson se në bazë të nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit parashihet që tre pagat e papaguara të fundit të punonjësve janë kërkesa preferenciale dhe si të tilla mbajnë prioritet më të lartë. Megjithatë, kjo dispozitë nuk i jep të drejtë të gjithë punonjësve për tri paga, por i jep prioritet tre pagave të fundit të cilat eventualisht kanë mbetur të papaguara prej numrit të pagave të cilat NSH pretendohet se nuk i ka paguar punonjësve. Sidoqoftë, kërkesa për paga të papaguara duhet të mbështetet me dëshmi në mbështetje të ekzistencës së një obligimi të tillë. Neni më lart nuk i jep automatikisht të drejtë të gjithë punonjësve për këto tri paga. Me tej e paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se ”...*elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme*”. Tutje e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: “*pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet*”. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur NSH-ja pretendohet se nuk e ka përmbushur obligimin qe rrjedh nga marrëdhënia e punës qe është me se voni 3 vjet nga koha kur parashtruesi pretendohet se nuk e ka marr rrogën ne vitin 2006, nuk ka dëshmi se parashtruesi e ka parashtruar këtë kërkesë në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e pavlefshme.

Për vendimin: PRN046-0542

E paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se ”...*elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme*”. E paditura pohoi se nuk ka dëshmi se parashtruesi e ka parashtruar këtë kërkesë në gjykatë apo autoritet tjetër kompetente që nga Dhjetori i vitit 2002 kur rroga pretendohet se ka mbetur papaguar. Me tej e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: “*pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet*”. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur NSH-ja pretendohet se nuk e ka përmbushur obligimin qe rrjedh nga marrëdhënia e punës qe është me se voni 3 vjet nga Marsi i vitit 2005, kur parashtruesi pretendohet se nuk e ka marr rrogën, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e parashkruar dhe si e tillë është refuzuar si e pavlefshme.

Për vendimin: PRN046-0691

E paditura- AKP thekson se në bazë të nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit parashihet që tre pagat e papaguara të fundit të punonjësve janë kërkesa preferenciale dhe si të tilla mbajnë prioritet më të lartë. Megjithatë, kjo dispozitë nuk i jep të drejtë të gjithë punonjësve për tri paga, por i jep prioritet tre pagave të fundit të cilat eventualisht kanë mbetur të papaguara prej numrit të pagave të cilat NSH pretendohet se nuk i ka paguar punonjësve. Sidoqoftë, kërkesa për paga të papaguara duhet të mbështetet me dëshmi në mbështetje të ekzistencës së një obligimi të tillë. Neni më lart nuk i jep automatikisht të drejtë të gjithë punonjësve për këto tri paga. Me tej e paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *“...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. Tutje e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”*. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur NSH-ja pretendohet se nuk e ka përmbushur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës që është me se voni 3 vjet nga koha kur parashtruesi pretendohet se nuk e ka marr rrogën në Janar të vitit 2006, nuk ka dëshmi se parashtruesi e ka parashtruar këtë kërkesë në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e pavlefshme.

Për vendimet: PRN046-0689 dhe PRN046-0388

E paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *“...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. E paditura pohoi se nuk ka dëshmi se parashtruesi e ka parashtruar këtë kërkesë në gjykatë apo autoritet tjetër kompetente që nga Dhjetori i vitit 2002 kur rroga pretendohet se ka mbetur papaguar. Me tej e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”*. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur NSH-ja pretendohet se nuk e ka përmbushur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës që është me se voni 3 vjet nga Marsi i vitit 2005, kur parashtruesi pretendohet se nuk e ka marr rrogën, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e parashkruar dhe si e tillë është refuzuar si e pavlefshme.

Për vendimet: PRN046-0389 dhe PRN046-0889

E paditura- AKP thekson se në bazë të nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit parashihet që tre pagat e papaguara të fundit të punonjësve janë kërkesa preferenciale dhe si të tilla mbajnë prioritet më të lartë. Megjithatë, kjo dispozitë nuk i jep të drejtë të gjithë punonjësve për tri paga, por i jep prioritet tre pagave të fundit të cilat eventualisht kanë mbetur të papaguara prej numrit të pagave të cilat NSH pretendohet se nuk i

ka paguar punonjësve. Sidoqoftë, kërkesa për paga të papaguara duhet të mbështetet me dëshmi në mbështetje të ekzistencës së një obligimi të tillë. Neni më lart nuk i jep automatikisht të drejtë të gjithë punonjësve për këto tri paga. Me tej e paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *”...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. Tutje e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”*. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur NSH-ja pretendohet se nuk e ka përmbushur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës që është me se voni 3 vjet nga koha kur parashtruesi pretendohet se nuk e ka marr rrogën e fundit, nuk ka dëshmi se parashtruesi e ka parashtruar këtë kërkesë në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e pavlefshme.

Për vendimin: **PRN046-0875**

E paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *”...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. E paditura pohoi se nuk ka dëshmi se parashtruesi e ka parashtruar këtë kërkesë në gjykatë apo autoritet tjetër kompetente që nga kur rroga pretendohet se ka mbetur papaguar. Me tej e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”*. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur NSH-ja pretendohet se nuk e ka përmbushur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës që është me se voni 3 vjet nga koha kur parashtruesi pretendohet se nuk e ka marr rrogën, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e parashtruar dhe si e tillë është refuzuar si e pavlefshme.

Për vendimet: **PRN046-0697 dhe PRN046-0898**

E paditura- AKP thekson se në bazë të nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit parashihet që tre pagat e papaguara të fundit të punonjësve janë kërkesa preferenciale dhe si të tilla mbajnë prioritet më të lartë. Megjithatë, kjo dispozitë nuk i jep të drejtë të gjithë punonjësve për tri paga, por i jep prioritet tre pagave të fundit të cilat eventualisht kanë mbetur të papaguara prej numrit të pagave të cilat NSH pretendohet se nuk i ka paguar punonjësve. Sidoqoftë, kërkesa për paga të papaguara duhet të mbështetet me dëshmi në mbështetje të ekzistencës së një obligimi të tillë. Neni më lart nuk i jep automatikisht të drejtë të gjithë punonjësve për këto tri paga. Me tej e paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *”...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. Tutje e

paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”*. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur NSH-ja pretendohet se nuk e ka përmbushur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës që është me se voni 3 vjet nga koha kur parashtruesi pretendohet se nuk e ka marr rrogën në Janar të vitit 2006, nuk ka dëshmi se parashtruesi e ka parashtruar këtë kërkesë në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e pavlefshme.

Për vendimet: PRN046-0696 dhe PRN046-0573

E paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *“...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. E paditura pohoi se nuk ka dëshmi se parashtruesi e ka parashtruar këtë kërkesë në gjykatë apo autoritet tjetër kompetente që nga, kur rroga pretendohet se ka mbetur papaguar. Me tej e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”*. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur NSH-ja pretendohet se nuk e ka përmbushur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës që është me se voni 3 vjet nga koha kur parashtruesi pretendohet se nuk e ka marr rrogën, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e parashkruar dhe si e tillë është refuzuar si e pavlefshme.

Për vendimet: PRN046-0577 dhe PRN046-0646

E paditura- AKP thekson se në bazë të nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit parashihet që tre pagat e papaguara të fundit të punonjësve janë kërkesa preferenciale dhe si të tilla mbajnë prioritet më të lartë. Megjithatë, kjo dispozitë nuk i jep të drejtë të gjithë punonjësve për tri paga, por i jep prioritet tre pagave të fundit të cilat eventualisht kanë mbetur të papaguara prej numrit të pagave të cilat NSH pretendohet se nuk i ka paguar punonjësve. Sidoqoftë, kërkesa për paga të papaguara duhet të mbështetet me dëshmi në mbështetje të ekzistencës së një obligimi të tillë. Neni më lart nuk i jep automatikisht të drejtë të gjithë punonjësve për këto tri paga. Me tej e paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *“...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. Tutje e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”*. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur NSH-ja pretendohet se nuk e ka përmbushur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës që është me

se voni 3 vjet nga koha kur parashtruesi pretendohet se nuk e ka marr rrogën, nuk ka dëshmi se parashtruesi e ka parashtruar këtë kërkesë në gjykate apo autoritet tjetër kompetent, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e pavlefshme.

Për vendimin: PRN046-0648

E paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *”...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. E paditura pohoi se nuk ka dëshmi se parashtruesi e ka parashtruar këtë kërkesë në gjykate apo autoritet tjetër kompetente që nga, Dhjetori i vitit 2005, kur rroga pretendohet se ka mbetur papaguar. Me tej e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”*. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur NSH-ja pretendohet se nuk e ka përmbyllur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës që është me se voni 3 vjet nga koha kur parashtruesi pretendohet se nuk e ka marr rrogën nga Marsi i vitit 2005, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e parashkruar dhe si e tillë është refuzuar si e pavlefshme.

Për vendimet: PRN046-0172, PRN046-0400, PRN046-0374, PRN046-0508, PRN046-0503, PRN046-0603, PRN046-0620, PRN046-0428, PRN046-0419, PRN046-0884, PRN046-0632, PRN046-0659, PRN046-0866 dhe PRN046-0870.

AKP thekson se sipas arkivës së privatizimit, privatizimi i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë (në likuidim) është përmbyllur me 24 mars 2006 dhe marrëdhënia e punës së të gjithë punonjësve të NSH-së është ndërprerë gjatë muajit mars 2006. E paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *”...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. E paditura pohoi se nuk ka dëshmi se parashtruesi e ka parashtruar këtë kërkesë në gjykate apo autoritet tjetër kompetent. Me tej e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”*. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur parashtruesi kishte fituar te drejtën për të parashtruar kërkesë për dëmshpërblim për ndërprerje te parakohshme te kontratës së punës, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e parashkruar dhe si e tillë është refuzuar si e pavlefshme.

Për vendimin: PRN046-0583

AKP thekson se bazuar evidencave të brendshme të NSH-se parashtruesi i kërkesës nuk duket se ka qene në listën me të fundit të punonjësve, ose në liste përfundimtare të punonjësve që kanë qene të punësuar deri në ditën e privatizimit që ishte 24 Mars 2006, Tutje pohon se nuk ka dëshmi që dëshmon se iu ndërpre marrëdhënia e punës si pasoje e privatizimit të NSH-së. E

paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *”...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. Me tej e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”*. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur parashtruesi kishte fituar te drejtën për te parashtruar kërkesë për dëmshpërblim për ndërprerje te parakohshme te kontratës së punës, ne Qershor te vitit 2008, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e parashkruar dhe si e tillë është refuzuar si e pavlefshme.

Për vendimet: **PRN046-0651, PRN046-0441, PRN046-0336, PRN046-0386, PRN046-0640, PRN046-0791, PRN046-0873 dhe PRN046-0390.**

AKP thekson se sipas arkivës së privatizimit, privatizimi i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë (në likuidim) është përmbyllur me 24 mars 2006 dhe marrëdhënia e punës së të gjithë punonjësve të NSH-së është ndërprerë gjatë muajit mars 2006. E paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *”...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. Me tej e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”*. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur parashtruesi kishte fituar te drejtën për te parashtruar kërkesë për dëmshpërblim për ndërprerje te parakohshme te kontratës së punës në Qershor të vitit 2008, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e parashkruar dhe si e tillë është refuzuar si e pavlefshme.

Për vendimin: **PRN046-0936**

AKP thekson se bazuar në dokumentacionin e bashkëlidhur me kërkesën, si dhe konsultimin e duhur me te dhënat e brendshme të NSH-së, parashtruesi është pushur nga puna me 24 Mars 2006. E paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se *”...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. Me tej e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”*. Me tej e paditura pohon se nuk ka dëshmi pranë autoritetit të likuidimit se kërkesa është paraqitur në gjykatë apo ndonjë autoritet kompetent nga viti 2002, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e parashkruar dhe si e tillë është refuzuar si e pavlefshme.

Për vendimet: **PRN046-0995, PRN046-0670, PRN046-0512, PRN046-0601, PRN046-0438, PRN046-0367, PRN046-0543, PRN046-0387, PRN046-0890, PRN046-0877, PRN046-0695, PRN046-0413, PRN046-0575 dhe PRN046-0650.**

AKP thekson se sipas arkivës së privatizimit, privatizimi i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë (në likuidim) është përmyllur me 24 mars 2006 dhe marrëdhënia e punës së të gjithë punonjësve të NSH-së është ndërprerë gjatë muajit mars 2006. E paditura thekson se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se “...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”. Me tej e paditura thekson se Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 parasheh që: “pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”. Në varësi të dispozitës së mësipërme, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri vitesh nga koha kur parashtruesi kishte fituar te drejtën për të parashtruar kërkesë për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në Qershor të vitit 2008, prandaj AL ka ardhur në përfundim se kërkesa është e parashkruar dhe si e tillë është refuzuar si e pavlefshme.

E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj ka bashkangjitur: vendimet e kundërshtuara për secilin ankues, dhe formularët për parashtrimin e kërkesës kreditore për secilin ankues.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesat aprovohen si pjesërisht të bazuara dhe ndryshohen vendimet e kundërshtuara të AL, dhe disa vendime të AL-së vërtetohen, si në vijim:

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e

tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Gjykata jep pjesën e veçantë të arsyetimit për secilin nga ankuesit dhe atë si në vijim:

1. **N I- PRN046-0373, PRN046-0374, PRN046-0375**

Kërkesa e ankuesit N I në lidhje me vendimin **PRN046-0373, për tre paga të papaguara**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0373, i datës 10.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 218 dhe nr. i amzës 250, për tre paga 1.055.97 € (351.99 x 3 =1.055.97).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur,

apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.055.97 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 218 dhe nr. i amzës 250, për tre paga në shumë prej 1.055.97 € ($351.99 \times 3 = 1.055.97$).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin e pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi N I kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit N I në lidhje me vendimin **PRN046-0374, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0374, i datës 10.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Librezën e Punës, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 21 vite e 08 muaj e 08 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 351.99 €, apo shumës totale prej 1.407.96 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **703.98 €** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit N I në lidhje me vendimin **PRN046-0375, për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002- mars 2003, janar-mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar-mars 2005,

aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0375, i datës 10.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, si dhe nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit N I i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.655.17 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.138.52 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 152.02 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 658.09 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 327.06 €, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e papaguara në shumë prej 1.138.52 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me

njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi N I kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 360.24 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

2. I S- PRN046-0507, PRN046-0508

Kërkesa e ankuesit I S në lidhje me vendimin **PRN046-0507, për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002- mars 2003, janar-mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0375, i datës 05.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, si dhe nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit I S i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.631.98 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005

dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.122.55 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 149.91 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 649.63 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 323.01 €, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 1.122.55 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësajsoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi I S, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësajsoj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit I S në lidhje me vendimin **PRN046-0508 për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0508, i datës 05.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Librezën e Punës, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006

dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 21 vite e 05 muaj e 23 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 346.85 €, apo shumës totale prej 1.387.4 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **693.7 €** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 250.99 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

3. R B - PRN046-0504, PRN046-0503, PRN046-0505

Kërkesa e ankuesit R B në lidhje me vendimin **PRN046-0504, për tre paga të papaguara**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0504, i datës 05.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 218 dhe nr. i amzës 250, për tre paga 1.055.97 € ($351.99 \times 3 = 1.055.97$).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 782.11 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 263 dhe nr. i amzës 13, për tre paga në shumë prej 782.11 € ($260.70 \times 3 = 782.11$).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj

pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështoj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështoj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështoj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi R B, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështoj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit R B në lidhje me vendimin **PRN046-00503, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0503 i datës 05.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga lista e 20 % e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 22.90 vite, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Listën e 20 %, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 260.70 €, apo shumës totale prej 1.042.80 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **521.40 €** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit R B në lidhje me vendimin **PRN046-0505 për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002- mars 2003, janar-mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0505 i datës 05.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit R B i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.237.57 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime punë për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 851.67 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 113.67 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 492.26 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 245.74 €. Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e papaguara në shumë prej 851.67 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vë në përfundim se ankuesi R B, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 267.65 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

4. D Z - PRN046-0606, PRN046-0603 dhe PRN046-0605

Kërkesa e ankuesit D Z në lidhje me vendimin **PRN046-0606, për tre paga të papaguara**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0606, i datës 05.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndër marr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimit të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 60 dhe nr. i amzës 174, për tre paga 1.018.27 € (339.42 x 3 =1.018.27).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.018.27 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 60 dhe nr. i amzës 174, për tre paga në shumë prej 1.018.27 € (339.42 x 3 =1.018.27).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrorë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrorë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi D Z, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit D Z në lidhje me vendimin **PRN046-0603, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0603, i datës 05.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga

lista e 20 % e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 21.89 vite, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 339.42 €, apo shumës totale prej 1.357.67€, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **678.84 €** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit D Z në lidhje me vendimin **PRN046-0605, për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002- mars 2003, janar-mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0605, i datës 05.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi

ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit D Z i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.597.65 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.099.02 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 146.74 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 635.96 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 316.32 €. Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e papaguara në shumë prej 1.099.02 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi D Z, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 347.49 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume

themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalohet 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

5. J R- PRN046-0625, PRN046-0620, PRN046-0623

Kërkesa e ankuesit J R në lidhje me vendimin **PRN046-0625, për tre paga të papaguara**, aprovet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0625, i datës 10.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmar veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 162 dhe nr. i amzës 80, për tre paga 1.059.34 € (353.11 x 3 =1.059.34).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.059.34 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 162 dhe nr. i amzës 80, për tre paga në shumë prej 1.059.34 € (353.11 x 3 =1.059.34).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin e pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi J R kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit J R në lidhje me vendimin **PRN046-0620, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0620, i datës 05.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006,

Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga lista e 20 % e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 22.40 vite, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 353.11 €, apo shumës totale prej 1.412.44€, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **706.22€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit J R në lidhje me vendimin **PRN046-0623, për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002 deri në mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0623, i datës 10.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës

së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit J R i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.660.37 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.142.08 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 152.50 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 660.97 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 328.61 €, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 1.142.08 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi J R kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 361.38 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume

themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalohet 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

6. S R - PRN046-0429, PRN046-0428, PRN046-0432

Kërkesa e ankuesit S R në lidhje me vendimin **PRN046-0429**, për tre paga të papaguara, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0429, i datës 12.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor, ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 269 dhe nr. i amzës 59, për tre paga 1.060.94 € (353.65 x 3 =1.060.94).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.060.94 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 269 dhe nr. i amzës 59, për tre paga në shumë prej 1.060.94 € (353.65 x 3 = 1.060.94).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsytuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin e pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi S R, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit S R në lidhje me vendimin **PRN046-0428, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0428, i datës 12.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Librezën e Punës, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 22 vite e 06 muaj e 12 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 353.65 €, apo shumës totale prej 1.414.60 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **707.30 €** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit S R në lidhje me vendimin **PRN046-0432, për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002- mars 2003, janar-mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar-mars 2005, aprovet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0432, i datës 12.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, si dhe nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit S R i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.662.85€, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.143.79 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 152.73 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 661.97 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 329.09 €, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e papaguara në shumë prej 1.143.79 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi S R, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësij i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 361.93 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

7. R A - PRN046-0864

Kërkesa e ankuesit R A në lidhje me vendimin **PRN046-0864 për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002 deri në mars 2005, refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet vendimi i AL nr. PRN046-0864, i datës 19.02.2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me NSH në fjalë, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh pagat e kërkuara për periudhën dhjetor 2002-mars 2005. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të kërkesës së tij edhe pas urdhrin të lëshuar nga gjykata të datës 02 tetor 2024. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive relevante, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Gjykata konstaton se Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, Libreza e Punës si dhe lista e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj, lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, e dorëzuar si provë nga ankuesi nuk vërteton se NSH-ja i ka mbetur borxh ankuesit pagat të cilat i kërkon për periudhën Dhjetor 2002-Mars 2005, andaj gjykata nuk mund ti merr për bazë si të vetme këto prova për ti njohur të drejtën në kompensim për paga të papaguara.

Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive relevante, pretendimet e ankuesit R A lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

8. E A - PRN046-0381, PRN046-0419, PRN046-0418

Kërkesa e ankuesit E A në lidhje me vendimin **PRN046-0381, për tre paga të papaguara**, aprovet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0381, i datës 10.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 66 dhe nr. i amzës 217, për tre paga 1.046.88 € (348.96 x 3 =1.046.88).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.046.88€, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 66 dhe nr. i amzës 217, për tre paga në shumë prej 1.046.88 € (348.96 x 3 =1.046.88).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësioj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kësioj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kësioj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin e pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kësioj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi E A, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësioj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit E A në lidhje me vendimin **PRN046-0419, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0419, i datës 12.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Librezën e Punës, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 21 vite e 09 muaj e 11 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 348.96 €, apo shumës totale prej 1.395.84 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **697.92 €** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit E A në lidhje me vendimin **PRN046-0418, për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002 deri në mars 2005, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0418, i datës 12.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është

çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, si dhe nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit E A i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 483.91€, për muajt dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 483.91 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2004 i është njohur paga për muajin dhjetor në shumë prej 159.05 € ndërsa për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, dhe mars 2005 në shumë prej 483.91 €, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 483.91€, ndërsa për muajt dhjetor 2002, janar-mars 2003, dhe janar-mars 2004, nuk figuron në listë ndonje borxh i mbetur nga NSH-ja për ankuesin.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi E A, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 292.66 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të

lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

9. B H - PRN046-0886, PRN046-0884, PRN046-0880

Kërkesa e ankuesit B H në lidhje me vendimin **PRN046-0886, për tre paga të papaguara**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0886, i datës 19.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 36 dhe nr. i amzës 495, për tre paga 1.774.53 € (591.51 x 3 =1.774.53).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.774.53 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 36 dhe nr. i amzës 495, për tre paga në shumë prej 1.774.53 € ($591.51 \times 3 = 1.774.53$).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësioj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kësioj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kësioj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin e pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kësioj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi B H, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësioj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit B H në lidhje me vendimin **PRN046-0884, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0884, i datës 19.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Librezën e Punës, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 16 vite e 07 muaj e 27 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të tre pagave mujore në lartësi prej 591.51 €, apo shumës totale prej 1.774.53 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (III) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 10 deri në 19 vjet stazh, e ka përcaktuar në tre paga mujore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit B H në lidhje me vendimin **PRN046-0880, për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002- mars 2003, janar-mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar-mars 2005, aprovet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0880, i datës 19.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi

ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, si dhe nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit B H i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 2.735.62€, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.883.27 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 251.98 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 1.088.92 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 542.37 €, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e papaguara në shumë prej 1.883.27 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi B H, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 543.23 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume

themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

10. **K I - PRN046-0629, PRN046-0632, PRN046-0630**

Kërkesa e ankuesit K I në lidhje me vendimin **PRN046-0629, për tre paga të papaguara**, aprovet si i bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0629, i datës 10.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmar veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor, ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 166 dhe nr. i amzës 94, për tre paga 858.75€ (286.25 x 3 =858.75).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 858.75 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 166 dhe nr. i amzës 94, për tre paga në shumë prej 858.75 € (286.25 x 3 =858.75).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kësisoj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kësisoj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kësisoj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi K I, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit K I në lidhje me vendimin **PRN046-0632, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjeserisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0632, i datës 10.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën

përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Lista e 20% e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 22.39 vite, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Listën e 20%, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 286.25 €, apo shumës totale prej 1.145.00 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **572.50 €** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit K I në lidhje me vendimin **PRN046-0630, për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002 deri mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0630, i datës 10.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës

së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit K I i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1354.32€, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime punë për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 931.89 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 124.39 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 538.85 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 268.65 €. Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e papaguara në shumë prej 1.883.27 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vë në përfundim se ankuesi K I, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 293.56 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume

themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalohet 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

11. M I - PRN046-0659, PRN046-0658

Kërkesa e ankuesit M I në lidhje me vendimin **PRN046-0659, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si e pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0659, i datës 12.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Librezën e Punës, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 21 vite e 08 muaj e 06 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 283.30 €, apo shumës totale prej 1.133.20 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **566.60 €** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit M I në lidhje me vendimin **PRN046-0658, për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002- mars 2003, janar-mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0658, i datës 19.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, si dhe nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit M I i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 541.28€, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt dhe mars të vitit 2003.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën dhjetor 2002, janar, shkurt dhe mars të vitit 2003, dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat

përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 123.13 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 123.13 Euro me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP. Ndërsa për pagat tjera të cilat i ka kërkuar ankuesi për muajt janar, shkurt mars dhe dhjetor të vitit 2004, dhe janar, shkurt dhe mars të vitit 2005, gjykata i refuzon në mungesë të provave, pasi që në listën e rrogave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006, nuk figuron ndonjë borxh i mbetur për këta muaj për ankuesin.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi M I, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 125.63 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

12. A Z- PRN046-0868, PRN046-0866, PRN046-0865

Kërkesa e ankuesit A Z në lidhje me vendimin **PRN046-0868, për tre paga të fundit të papaguara**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0868, i datës 19.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga të fundit të papaguara, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të

Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 10 dhe nr. i amzës 272, për tre paga 1.055.96 € (351.99 x 3 =1.055.96).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës prej **540.00 Euro** për tre paga € (180x 3 =540.00). gjykata vendos në bazë të kërkeses kreditore të ankuesit.

Gjykata konstaton se në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 10 dhe nr. i amzës 272, për tre paga dhe figuron shuma prej 1.055.96 € (351.99 x 3 =1.055.96), mirëpo Gjykata me rastin vendosjes, në pajtim me nenin 76.3 të Ligjit për DHPGJS lidhur me nenin 2.1 të Ligjit për procedurën kontestimore vendosi në suaza të kërkesës kreditore të ankuesit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kësisoj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera,

të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrorë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrorë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi A Z kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit A Z në lidhje me vendimin **PRN046-0866, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0866, i datës 19.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashtruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Librezën e Punës, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 21 vite e 09 muaj e 07 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka

dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 351.99 €, apo shumës totale prej 1.407.96 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **703.98 €** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit A Z në lidhje me vendimin **PRN046-0865 për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002 deri në mars 2003, refuzohet se e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL nr. PRN046-0865, i datës 19.02.2014, si i drejtë dhe i bazuar me ligj.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuara), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se

ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, si dhe nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit A Z per muajt dhjetor 2002, janar-mars 2003, nuk i ka mbetur ndonjë borxh ankuesit.

Në këtë rast gjykata nga shkresat e lëndës vie në përfundim se përveç se ka parashkrim të kërkesës për muajt dhjetor 2002, janar dhe shkurt të vitit 2003, po ashtu ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh pagat e kërkuara për periudhën dhjetor 2002- mars 2003. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive relevante, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 194.79 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

13. Z V - PRN046-0869 dhe PRN046-0870

Kërkesa e ankueses Z V në lidhje me vendimin **PRN046-0869, për tre paga të papaguara**, refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet vendimi i AL nr. PRN046-0869, i datës 19.02.2014, si i drejtë dhe i bazuar me ligj.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen

faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Kërkesa e ankuesit ka të bëjë me tre pagat e pa paguara për periudhën Janar-Mars 2005 në shumë prej 540.00€, të cilat pretendohet të mos jenë paguar nga ana e NSH-së. Neni 40 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP parasheh prioritetin e kërkesave dhe interesave që duhet të përmbushen në procedurë të likuidimit, ndërsa pika 1.6.1 e po të njëjtit nen, parasheh pagesën e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto.

Gjykata gjen se kërkesa është e pabazuar për faktin se Shtojca e Ligjit për AKP-në neni 40, paragrafi 1.6.1 i referohet vetëm prioritetit të tri (3) pagave të fundit të papaguara. Prioriteti i lartë megjithatë nuk ia njeh automatikisht të drejtën e punëtorit për tri pagat por i jep prioritet në mesin e borxheve të tri pagave të fundit të cilat mund të kenë mbetur pa u paguar. Në çdo rast, një kërkesë e tillë duhet të jetë e mbështetur me prova, me anë të së cilave do të vërtetohej fakti se NSH i ka mbetur borxh ankuesit pagat e kërkuara.

Gjykata konstaton se provat e dorëzuara në kopje nga ankuesi siç janë: kontrata e punës e datës 01.06.2003, njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies se punës e datës 24 mars 2006, lista e 20%, si dhe lista e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj të datës 31.03.2006, nuk vërtetojnë faktin se NSH-ja i ka mbetur borxh 3 pagat e kërkuara ankueses.

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesja ka krijuar marrëdhënie pune me NSH në fjalë, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh 3 pagat e kërkuara.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankueses është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive relevante, pretendimet e ankueses lidhur me të drejtën e tij në kompensim për tri paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Kërkesa tjetër e ankueses Z V në lidhje me vendimin **PRN046-0870, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0870, i datës 19.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë

e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesja kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankueses për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Lista e 20% e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesja kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 5.64 vite, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Listën e 20%, dhe Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesja ka qenë punëto e NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankueses është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Me rastin e aprovimit të dy pagave mujore në lartësi prej 179.00 €, apo shumës totale prej 358.00 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e saj të punës - listën e përfitimit të 20%-shit, dhe kontratën e punë se datës 01.06.2003. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (ii) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 5 deri në 9 vjet stazh, e ka përcaktuar në dy paga mujore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesja ishte një punëto e NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 35.8 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të

lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

14. V R - PRN046-0559 dhe PRN046-0583

Kërkesa e ankuesit V R në lidhje me vendimin **PRN046-0559, për tre paga të papaguara**, refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet vendimi i AL nr. PRN046-0559, i datës 05.02.2014, si i drejtë dhe i bazuar me ligj.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësata apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Kërkesa e ankuesit ka të bëjë me tre pagat e pa paguara për periudhën Janar-Mars 2006 në shumë prej 540.00€, të cilat pretendohet të mos jenë paguar nga ana e NSH-së. Neni 40 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP parasheh prioritetin e kërkesave dhe interesave që duhet të përmbushen në procedurë të likuidimit, ndërsa pika 1.6.1 e po të njëjtit nen, parasheh pagesën e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto.

Gjykata gjen se kërkesa është e papabazuar për faktin se Shtojca e Ligjit për AKP-në neni 40, paragrafi 1.6.1 i referohet vetëm prioritetit të tri (3) pagave të fundit të papaguara. Prioriteti i lartë megjithatë nuk ia njeh automatikisht të drejtën e punëtorit për tri pagat por i jep prioritet në mesin e borxheve të tri pagave të fundit të cilat mund të kenë mbetur pa u paguar. Në çdo rast, një kërkesë e tillë duhet të jetë e mbështetur me prova, me anë të së cilave do të vërtetohej fakti se NSH i ka mbetur borxh ankuesit pagat e kërkuara.

Gjykata konstaton se provat e dorëzuara në kopje nga ankuesi siç janë: librezja e punës, aktvendimi mbi themelimin e marrëdhënies së punës ne kohe te pacaktuar dhe përcaktimin ne pune dhe detyra te punës, nr.8203, i dt.03.12.1990, aktvendimin lidhur me përcaktimin e bazës

për llogaritjen e te ardhurave personale nr.723, dt.24.10.2000, formularin e kërkesës kreditore, i dt.25.09.2013, njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies se punës e datës 24 mars 2006, lista e 20%, si dhe lista e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj të datës 31.03.2006, nuk vërtetojnë faktin se NSH-ja i ka mbetur borxh 3 pagat e kërkuara ankuesit.

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me NSH në fjalë, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh 3 pagat e kërkuara. Nga lista e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj të datës 31.03.2006, lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së nuk figuron emri i ankuesit fare e as ndonjë borxh i mbetur.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive relevante, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për tri paga të pa paguara janar - mars 2006, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Kërkesa tjetër e ankuesit V R në lidhje me vendimin **PRN046-0583, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0583, i datës 05.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesja kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankueses për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Lista e 20% e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesja kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 15.56 vite, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Listën e 20%, dhe Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesja ka qenë punëtore e NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Me rastin e aprovimit të tri pagave mujore në lartësi prej 180 €, apo shumës totale prej 540.00 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e saj të punës - listën e përfitimit të 20%-shit, aktvendimi mbi themelimin e marrëdhënies së punës në kohe të pacaktuar dhe përcaktimin në pune dhe detyra të punës, nr.8203, i dt.03.12.1990, dhe aktvendimin lidhur me përcaktimin e bazës për llogaritjen e te ardhurave personale nr.723, dt.24.10.2000. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iii) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 10 deri në 19 vjet stazh, e ka përcaktuar në tri paga mujore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 54.00 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalohet 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

15. **N B - PRN046-0598, PRN046-0651, PRN046-0652**

Kërkesa e ankuesit N B në lidhje me vendimin **PRN046-0598, për tre paga të papaguara**, aprovohet si i bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0598, i datës 12.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga të fundit të papaguara, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 206 dhe nr. i amzës 320, për tre paga 1.006.98€ (335.66 x 3 =1.006.98).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të shumës prej **660€uro** për tre paga, gjykata vendos në bazë të kërkesës kreditore të ankuesit.

Gjykata konstaton se në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 206 dhe nr. i amzës 320, për tre paga dhe figuron shuma prej 1.006.98€ (335.66 x 3 =1.006.98), mirëpo Gjykata me rastin vendosjes, në pajtim me nenin 76.3 të Ligjit për DHPGJS lidhur me nenin 2.1 të Ligjit për procedurën kontestimore vendosi në suaza të kërkesës kreditore të ankuesit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështoj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështoj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështoj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi N B kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështoj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit N B në lidhje me vendimin **PRN046-0651, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0651, i datës 12.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga librezja e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 21 vite e 10 muaj e 21 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, Listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 335.66 €, apo shumës totale prej 1.342.64 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **671.32 €** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit N B në lidhje me vendimin **PRN046-0652, për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002 - mars 2003, janar, mars, dhe dhjetor të vitit 2004, janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0652, i datës 12.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit N Bi ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.580.45€, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1087.19 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 145.16 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 629.08 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 312.95 €, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 1.883.27 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vë në përfundim se ankuesi N B kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 308.98€ në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

16. H K - PRN046-0442, PRN046-0441, PRN046-0440

Kërkesa e ankuesit H K në lidhje me vendimin **PRN046-0442, për tre paga të papaguara**, aprovohet si i bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0442, i datës 12.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndër marr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga të fundit të papaguara, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 116 dhe nr. i amzës 20, për tre paga 1.130.62€ (376.87 x 3 =1.130.62).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të shumës prej **600€uro** për tre paga, gjykata vendos në bazë të kërkesës kreditore të ankuesit.

Gjykata konstaton se në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 116 dhe nr. i amzës 20, për tre paga dhe figuron shuma prej 1.130.62€ (376.87 x 3 =1.130.62), mirëpo Gjykata

me rastin vendosjes, në pajtim me nenin 76.3 të Ligjit për DHPGJS lidhur me nenin 2.1 të Ligjit për procedurën kontestimore vendosi në suaza të kërkesës kreditore të ankuesit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi H K kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit H K në lidhje me vendimin **PRN046-0441, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0441, i datës 12.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga librezja e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 22 vite e 10 muaj e 17 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, Listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 376.87 €, apo shumës totale prej 1.507.48 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **753.74€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit H K në lidhje me vendimin **PRN046-0440**, për **paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002 - mars 2003, janar, mars, dhe dhjetor të vitit 2004, janar-mars 2005, aprovet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0440, i datës 12.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga Libreza e Punës dhe njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit H K i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.769.65€, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.214.08 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 162.56 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 704.56 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 346.96€, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 1.214.08 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi H K kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësorisj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 332.15€ në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

17. F D - PRN046-0337, PRN046-0336, PRN046-0338

Kërkesa e ankuesit F D në lidhje me vendimin **PRN046-0337, për tre paga të papaguara**, aprovohet si i bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0337, i datës 05.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga të fundit të papaguara, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 83 dhe nr. i amzës 160, për tre paga 1.057.71€, (352.57 x 3 =1.057.71).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur,

apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të shumës prej **953.84€uro** për tre paga, gjykata vendos në bazë të kërkesës kreditore të ankuesit.

Gjykata konstaton se në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 83 dhe nr. i amzës 160 për tre paga dhe figuron shuma prej 1.057.71€, ($352.57 \times 3 = 1.057.71$), mirëpo Gjykata me rastin vendosjes, në pajtim me nenin 76.3 të Ligjit për DHPGJS lidhur me nenin 2.1 të Ligjit për procedurën kontestimore vendosi në suaza të kërkesës kreditore të ankuesit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi F D kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit F D në lidhje me vendimin **PRN046-0336, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0336, i datës 05.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga librezja e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 21 vite e 10 muaj e 21 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, Listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 352.57 €, apo shumës totale prej 1.410.28 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **705.14€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit H K në lidhje me vendimin **PRN046-0338, për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002 - mars 2003, janar, mars, dhe dhjetor të vitit 2004, janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0338, i datës 05.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga Libreza e Punës dhe njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit F D i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.638.07€, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.126.8 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 150.45 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 652.1€, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 324.25€, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e papaguara në shumë prej 1.214.08 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi F D kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 349.09€ në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

18. A M - PRN046-0377, PRN046-0386, PRN046-0382

Kërkesa e ankuesit A M në lidhje me vendimin **PRN046-0377, për tre paga të papaguara**, aprovohet si pjesërisht i bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0377, i datës 10.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën

e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 25 dhe nr. i amzës 354, për tre paga 792.33€ (264.11 x 3 =792.33).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 792.33 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 25 dhe nr. i amzës 354, për tre paga në shumë prej 792.33€ (264.11 x 3 =792.33).

Pjesën e mbetur, prej **107.67€** gjykata e refuzon për arsye, sepse bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 166 dhe nr. i amzës 94, për tre paga në shumë prej 792.33€ (264.11 x 3 =792.33). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për lartësinë e pagave të cilat i kërkon në shumë prej 900.00 euro .

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund të atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi A M, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit A M në lidhje me vendimin **PRN046-0386, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0386, i datës 10.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkuar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga librezja e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 20 vite e 07 muaj e 19 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, Listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 264.11 €, apo shumës totale prej 1.056.44€, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **528.22€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit A M në lidhje me vendimin **PRN046-0382 për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002 - mars 2003, janar, mars, dhe dhjetor të vitit 2004, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0382, i datës 10.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga Libreza e Punës dhe njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit A M i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 901.82€, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 491.11 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 120.95 € ndërsa për vitin 2004 i është njohur paga për muajin dhjetor 2004 në shumë prej 121.36€, dhe për vitin 2005

i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 248.8€, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 491.11 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP. Ndërsa për pagat janar shkurt dhe mars të vitit 2004, refuzohen në mungesë të provave pasi që në listën e rrogave të mbetura borgj me nr.amz.354, lëshuar nga NSH-ja, nuk figuron ndonjë borgj i mbetur nga NSH-ja për keta muajt për ankuesin.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi A M kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 233.98€ në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

19. M I - PRN046-0642, PRN046-0640, PRN046-0641

Kërkesa e ankuesit M I në lidhje me vendimin **PRN046-0642, për tre paga të papaguara**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0642, i datës 12.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Kërkesa e ankuesit ka të bëjë me tre pagat e pa paguara për periudhën Janar-Mars 2006 në shumë prej 989.93€, të cilat pretendohet të mos jenë paguar nga ana e NSH-së. Neni 40 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP parasheh prioritetin e kërkesave dhe interesave që duhet të përmbushen në procedurë të likuidimit, ndërsa pika 1.6.1 e po të njëjtit nen, parasheh pagesën e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto.

Gjykata gjen se kërkesa është e pabazuar për faktin se Shtojca e Ligjit për AKP-në neni 40, paragrafi 1.6.1 i referohet vetëm prioritetit të tri (3) pagave të fundit të papaguara. Prioriteti i lartë megjithatë nuk ia njuh automatikisht të drejtën e punëtorit për tri pagat por i jep prioritet në mesin e borxheve të tri pagave të fundit të cilat mund të kenë mbetur pa u paguar. Në çdo rast, një kërkesë e tillë duhet të jetë e mbështetur me prova, me anë të së cilave do të vërtetohet fakti se NSH i ka mbetur borxh ankuesit pagat e kërkuara.

Gjykata konstaton se prova e dorëzuar në kopje nga ankuesi siç është librezja e punës, ku shihet se data e përfundimit të marrëdhënies së punës në NSH është 19.05.1999, si dhe nga lista e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj të dt.31.03.2006, lëshuar nga NSH-ja, ankuesi nuk figuron në atë liste fare.

Në këtë rast bazuar në shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi ka qene ne marrëdhënie pune vetem deri me 19.05.1999, pasi qe i njëjti ka vdekur me 19.05.1999, kjo vërtetohet me Certifikaten e tij të Vdekjes me nr V 00003308, të dt.17.10.2013, andaj nuk i takon kompensimi per pagat e kërkuara për periudhën Janar-Mars 2006, pasi qe ai nuk ka punuar per kete periudhe kohore.

Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive relevante, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për tri paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

24. J S - PRN046-0729, dhe PRN046-0728

Kërkesa e ankuesit J S në lidhje me vendimin **PRN046-0729, për tre paga të papaguara**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0729, i datës 19.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrës të tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit

Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtoret në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 164 dhe nr. i amzës 364, për tre paga 1.050.95 € (350.32 x 3 =1.050.95).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.050.95 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 164 dhe nr. i amzës 364 për tre paga në shumë prej 1.050.95 € (350.32 x 3 =1.050.95).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësijoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kësijoj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kësijoj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të

tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kësaj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi J S, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit J S në lidhje me vendimin **PRN046-0728 për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002- mars 2003, janar-mars dhe dhjetor 2004, janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0728, i datës 19.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezja e punës dhe njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit Jetullah Sinani i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.647.43 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.133.22 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i eshte njohur paga për muajin mars në shumë prej 151.31 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej

655.82 €, dhe per vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 326.09€, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 1.133.22 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe per muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi J S, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 218.41 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

25. F B - PRN046-0391, PRN046-0390, PRN046-0392

Kërkesa e ankuesit F B në lidhje me vendimin **PRN046-0391**, për tre paga të papaguara, aprovohet si i bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0391, i datës 10.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 74 dhe nr. i amzës 259, për tre paga 1.055.97€ (351.99 x 3 =1.055.97).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.055.97 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 74 dhe nr. i amzës 259, për tre paga në shumë prej 1.055.97€ (351.99 x 3 =1.055.97).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi F B, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit F B në lidhje me vendimin **PRN046-0390 për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0390, i datës 10.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Lista e 20% e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 21 vite, e 08 muaj, e 18 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 351.99 €, apo shumës totale prej 1.407.96 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **703.98 €** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit F B në lidhje me vendimin **PRN046-0392, për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002-mars 2003, janar-mars 2004, dhe dhjetor 2004, dhe janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0392 i datës 10.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezja e punës dhe nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit F B i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.655.17€, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.138.52 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 152.02 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 658.9 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë

prej 327.6 €, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 1.138.52€ me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi F B, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 360.24 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

26. B B - PRN046-0860

Kërkesa e ankuesit B B në lidhje me vendimin **PRN046-0860, për tre paga të papaguara**, aprovohet si i bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0860, i datës 19.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga të fundit të papaguara, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor, ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 51 dhe nr. i amzës 72, për tre paga 943.43€, (314.48 x 3 =943.43).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së.

Gjykata me rastin e aprovimit të shumës prej **660.00€uro**, është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj, e dt. 31 mars 2006, si dhe në bazë të kërkesës kreditore të ankuesit.

Gjykata konstaton se në listën e pagave të punëtorëve figuron shuma prej 943.43€, (314.48 x 3 =943.43), euro, në emër të pagave, mirëpo Gjykata me rastin vendosjes, në pajtim me nenin 76.3 të Ligjit për DHPGJS lidhur me nenin 2.1 të Ligjit për procedurën kontestimore vendosi në suaza të kërkesës kreditore të ankuesit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kësisoj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kësisoj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund

ti atribuohet ankuesit dhe kësaj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrorë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi B B kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 66.00 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

27. G H - PRN046-0940, PRN046-0635, PRN046-0936

Kërkesa e ankuesit G H në lidhje me vendimin **PRN046-0940, për tre paga të papaguara**, aprovohet si i bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0940, i datës 26.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga të fundit të papaguara, është parashtruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor, ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 103 dhe nr. i amzës 219, për tre paga 927.57€, (309.19 x 3 =927.57).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së.

Gjykata me rastin e aprovimit të shumës prej **660.00€uro**, është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj, e dt. 31 mars 2006, si dhe në bazë të kërkesës kreditore të ankuesit.

Gjykata konstaton se në listën e pagave të punëtorëve figuron shuma prej 927.57€, (309.19 x 3 =927.57), euro, në emër të pagave, mirëpo Gjykata me rastin vendosjes, në pajtim me nenin 76.3 të Ligjit për DHPGJS lidhur me nenin 2.1 të Ligjit për procedurën kontestimore vendosi në suaza të kërkesës kreditore të ankuesit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund të atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi G H kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit G H në lidhje me vendimin **PRN046-0635, për paga të papaguara**, për periudhën 09 mars 1998 deri në qershor 1999, refuzohet se e pa bazuar dhe vërtetohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0635 i datës 10.02.2014, si i drejtë dhe i bazuar me ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit, që si e tillë është çështje e rregulluar me dispozita ligjore dhe meqenëse gjykata konstaton se është parashkruar e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore përmbushjen e detyrimit, pretendimet e tjera të palëve nuk do të shqyrtohen.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh:

kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;

Gjykata gjen se neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), është i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së. Dispozita e nenit 608 parashikon se kërkesat monetare që rrjedhin nga marrëdhënia e punës parashkruhen për 3 vite.

Gjykata vlerëson se, për kohen kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohen dispozitat e atij Ligji. Gjykata gjithashtu vëren se me Ligjin e Punës nr. 03/L-212 i cili hyri në fuqi më 01 nëntor 2010, në dispozitat e tij qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha Ligjeve ekzistuese të Punës në Kosovë. Megjithatë, ky Ligji nuk parasheh parashkrim në lidhje me pagesat e të ardhurave, prandaj baza ligjore duhet kërkuar në legjislacionin në fuqi sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, të datës 12 dhjetor 1999 e cila siç u tha më lartë në nenin 1.1 pika b, parasheh si Ligj në fuqi në Kosovë legjislacionin i cili ishte në fuqi në Kosovë me 22 mars 1989.

Lidhur me parashkrimin rregullat e njëjta gjinden edhe në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978 i cili ishte në fuqi deri me hyrjen në fuqi më 19 dhjetor 2012 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD). Në pajtim me nenin 372,

paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së).

Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuara në atë kohë.

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar për paga të pa paguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me pagat e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Nga shkresat e lëndës rrjedh se ankuesi kërkesën për pagat e pa paguara e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit më 23 tetor 2013, brenda afatit për parashtrimin e kërkesave pranë AL-së, por që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkruar.

Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, është plotësisht i saktë. Gjukata vlerëson se me njoftimin e datës 24 mars 2006 parashkrimi është ndërprere për periudhën mars 2003 e tutje e jo për vitet 1998 e 1999 për te cilat ankuesi kërkon pagat e papaguara, dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin është i drejtë dhe gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Ankuesi ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit të pretenduar pas çdo muaji të kaluar për të cilët nuk i është paguar paga, kështu që afati i parashkrimit ka rrjedhur për çdo muaj të pagave të pa paguara veç e veç. Kërkesa e ankuesit për pagat e pa paguara për periudhën 09 mars 1998 deri në qershor 1999, është parashkruar brenda afatit 3 vjeçar.

Ankuesi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënë ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore pagat e pa paguara dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesit G H nuk i takon e drejta në kompensim për paga të papaguara për periudhën 09 Mars 1998- Qershor 1999.

Kërkesa tjetër e ankuesit G H në lidhje me vendimin **PRN046-0936, për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002 - mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0936 i datës 26.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezja e punës dhe nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit F B i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1,459,22€, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.003.95 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 134.02 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 580.72 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 289.21 €, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 1.003.95€ me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi G H kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësijoj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 166.39 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

28. Q M - PRN046-0992, PRN046-0995, PRN046-0994

Kërkesa e ankuesit Q M në lidhje me vendimin **PRN046-0992, për tre paga të papaguara**, aprovohet si i bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0992, i datës 24.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndër marr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga të fundit të papaguara, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor, ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 239 dhe nr. i amzës 185, për tre paga 1.056.91€, (352.30 x 3 =1.056.91).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur,

apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së.

Gjykata me rastin e aprovimit të shumës prej **953.16€uro**, është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj, e dt. 31 mars 2006, si dhe në bazë të kërkeses kreditore të ankuesit.

Gjykata konstaton se në listën e pagave të punëtorëve figuron shuma prej 1.056.91€, (352.30 x 3 = 1.056.91), euro, në emër të pagave, mirëpo Gjykata me rastin vendosjes, në pajtim me nenin 76.3 të Ligjit për DHPGJS lidhur me nenin 2.1 të Ligjit për procedurën kontestimore vendosi në suaza të kërkesës kreditore të ankuesit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur prirje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi Q M kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit Q M në lidhje me vendimin **PRN046-0995 për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0995, i datës 24.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 21 vite, e 17 muaj, e 50 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 352.30 €, apo shumës totale prej 1.409.2 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **704.6€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa e ankuesit Q M në lidhje me vendimin **PRN046-0994, për paga të papaguara**, refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet vendimi i AL nr. PRN046-0994, i datës 24.02.2014, si i drejtë dhe i bazuar me ligj.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Gjykata konstaton se provat e dorëzuara në kopje nga ankuesi siç janë: librezja e punës, njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës e datës 24 mars 2006, lista e 20%, si dhe lista e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj të datës 31.03.2006, nuk vërtetojnë faktin se NSH-ja i ka mbetur borxh pagat e kërkuara ankuesit.

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me NSH në fjalë, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh pagat e kërkuara për periudhën dhjetor 2002-mars 2003, janar-mars 2004 dhe dhjetor 2004, janar-mars 2005. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me llogaritjen e pagave të kërkuara. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të kërkesës së tij edhe pas urdhrit të lëshuar nga gjykata të datës 02 tetor 2024 për prova. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive relevante, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 236.23 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

29. E M - PRN046-0644, dhe PRN046-0938

Kërkesa e ankuesit E M në lidhje me vendimin **PRN046-0644, për paga të papaguara**, refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0644, i datës 12.02.2014, si i drejtë dhe i bazuar me ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit, që si e tillë është çështje e rregulluar me dispozita ligjore dhe meqenëse gjykata konstaton se është parashkruar e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore përmbushjen e detyrimit, pretendimet e tjera të palëve nuk do të shqyrtohen.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh:

kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;

Gjykata gjen se neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), është i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së. Dispozita e nenit 608 parashikon se kërkesat monetare që rrjedhin nga marrëdhënia e punës parashkruhen për 3 vite.

Gjykata vlerëson se, për kohen kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohen dispozitat e atij Ligji. Gjykata gjithashtu vëren se me Ligjin e Punës nr. 03/L-212 i cili hyri në fuqi më 01 nëntor 2010, në dispozitat e tij qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha Ligjeve ekzistuese të Punës në Kosovë. Megjithatë, ky Ligji nuk parasheh parashkrim në lidhje me pagesat e të ardhurave, prandaj baza ligjore duhet kërkuar në legjislacionin në fuqi sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, të datës 12 dhjetor 1999 e cila siç u tha më lartë në nenin 1.1 pika b, parasheh si Ligj në fuqi në Kosovë legjislacionin i cili ishte në fuqi në Kosovë me 22 mars 1989.

Lidhur me parashkrimin rregullat e njëjta gjinden edhe në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978 i cili ishte në fuqi deri me hyrjen në fuqi më 19 dhjetor 2012 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD). Në pajtim me nenin 372,

paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së).

Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuara në atë kohë.

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar për paga të pa paguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me pagat e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Nga shkresat e lëndës rrjedh se ankuesi kërkesën për pagat e pa paguara e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit më 23 tetor 2013, brenda afatit për parashtrimin e kërkesave pranë AL-së, por që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkruar.

Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, është plotësisht i saktë. Gjukata vlerëson se me njoftimin e datës 24 mars 2006 parashkrimi është ndërprere për periudhën mars 2003 e tutje e jo për vitin 1998 për të cilin ankuesi kërkon pagat e papaguara, dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin është i drejtë dhe gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Ankuesi ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit të pretenduar pas çdo muaji të kaluar për të cilët nuk i është paguar paga, kështu që afati i parashkrimit ka rrjedhur për çdo muaj të pagave të pa paguara veç e veç. Kërkesa e ankuesit për pagat e pa paguara për periudhën nga viti 1998, është parashkruar brenda afatit 3 vjeçar. Ankuesi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore pagat e pa paguara dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar.

Gjukata konstaton se edhe po të mos ishte parashkruar kërkesa, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh pagat e kërkuara për periudhën nga viti 1998, si dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me llogaritjen e pagave të kërkuara.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesit E M nuk i takon e drejta në kompensim për paga të papaguara për periudhën nga viti 1998.

Kërkesa tjetër e ankuesit E M në lidhje me vendimin **PRN046-0938, për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002 - mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0938 i datës 26.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezat e punës dhe nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit E M i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.668.66€, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.147.69 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 153.29 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 664.24 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 330.16 €, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e papaguara në shumë prej 1.147.69€ me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me

njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi E M kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 114.76 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

30. N V - PRN046-0643

Kërkesa e ankuesit N V në lidhje me vendimin **PRN046-0643 për paga të papaguara**, për periudhën nga viti 1998 e deri në ditën e privatizimit të NSH-së, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0643 i datës 12.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezat e punës dhe nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit N Vi ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.281.62€, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 567.49 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 155.45 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 345.17 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 66.87 €, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 567.48€ me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, e deri në vitin 1998 të cilat i ka kërkuar ankuesi të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi N V kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 56.74 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

31. A M - PRN046-0670, PRN046-0672

Kërkesa e ankuesit A M në lidhje me vendimin **PRN046-0670 për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0670, i datës 12.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 22 vite, e 07 muaj, e 25 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 376.46 apo shumës totale prej 1.505.84 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **752.92€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit A M në lidhje me vendimin **PRN046-0672, për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002 - mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0672 i datës 12.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura

e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezja e punës dhe nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit E M i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.767.96€, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.215.88 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 162.41 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 703.86€, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 349.61 €. Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 1.215.88€ me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi A M kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 272.17 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

32. A Zh - PRN046-0590 dhe PRN046-0588

Kërkesa e ankuesit A Zh në lidhje me vendimin **PRN046-0590, për tre paga të papaguara**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0590, i datës 12.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 20 dhe nr. i amzës 338, për tre paga 1.705.90 € (568.63 x 3 =1.705.90).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.705.90 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 20 dhe nr. i amzës 338, për tre paga në shumë prej 1.705.90 € (568.63 x 3 = 1.705.90).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin e pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi A Zh, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit A Zh në lidhje me vendimin **PRN046-0588 për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002- mars 2003, janar-mars dhe dhjetor 2004, janar-mars 2005, aprovet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0588, i datës 12.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi

ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezja e punës dhe njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit A Zh i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 2.635.48 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.813.99 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 242.93 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 1.049.16 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 521.9€, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 1.813.99 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi A Zh kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 181.39 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume

themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalohet 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

33. **B K - PRN046-0931, PRN046-0512, PRN046-0930**

Kërkesa e ankuesit B K në lidhje me vendimin **PRN046-0931, për tre paga të papaguara**, aprovet si i bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0931, i datës 26.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga të fundit të papaguara, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor, ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 45 dhe nr. i amzës 292, për tre paga 1.046.07€, (348.69 x 3 =1.046.07).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së.

Gjykata me rastin e aprovimit të shumës prej **660.00Euro**, është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj, e dt. 31 mars 2006, si dhe në bazë të kërkeses kreditore të ankuesit.

Gjykata konstaton se në listën e pagave të punëtorëve figuron shuma prej 1.046.07€, (348.69x 3 =1.046.07), euro, në emër të pagave, mirëpo Gjykata me rastin vendosjes, në pajtim me nenin 76.3 të Ligjit për DHPGJS lidhur me nenin 2.1 të Ligjit për procedurën kontestimore vendosi në suaza të kërkesës kreditore të ankuesit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kësisoj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kësisoj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kësisoj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi B K kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit B K në lidhje me vendimin **PRN046-0512 për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0512, i datës 10.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë

çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 20 vite, e 16 muaj, e 26 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 348.69 €, apo shumës totale prej 1.394.76 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **697.38€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit B K në lidhje me vendimin **PRN046-0930 për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002- mars 2003, janar-mars dhe dhjetor 2004, janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0930, i datës 26.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezja e punës dhe njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit B K i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.639.93 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 977.45 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 242.93 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 652.83 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 324.62€, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 977.45 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi B K, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 181.39 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

34. B B - PRN046-0724 dhe PRN046-0723

Kërkesa e ankuesit B B në lidhje me vendimin **PRN046-0724, për tre paga të papaguara**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0724, i datës 19.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërrerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 56 dhe nr. i amzës 85, për tre paga 839.71 € (279.90 x 3 =839.71).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur,

apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 839.71 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 56 dhe nr. i amzës 85, për tre paga në shumë prej 839.71 € ($279.90 \times 3 = 839.71$).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi B B, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit B B në lidhje me vendimin **PRN046-0723 për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002- mars 2003, janar-mars dhe dhjetor 2004, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0723, i datës 19.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk

e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezja e punës dhe njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit B B i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.200.00 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004, si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhe dhjetor 2004, dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 655.12 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 127.90 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 655.12 €. Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 655.12 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi B B, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 149.48 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume

themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalohet 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

35. I H - PRN046-0600, PRN046-0601 dhe PRN046-0599

Kërkesa e ankuesit I H në lidhje me vendimin **PRN046-0600**, për tre paga të papaguara, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0600, i datës 12.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 128 dhe nr. i amzës 108, për tre paga 935.37 € (311.79 x 3 =935.37).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 935.37 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 128 dhe nr. i amzës 108, për tre paga në shumë prej 935.37 € (311.79 x 3 =935.37).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin e pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi I H, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit I H në lidhje me vendimin **PRN046-0601 për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0601, i datës 05.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 22 vite, e 01 muaj, e 23 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 311.79 €, apo shumës totale prej 1.247.16 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **623.58€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit I H në lidhje me vendimin **PRN046-0599 për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002- mars 2003, janar-mars dhe dhjetor 2004, janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0599, i datës 12.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është

çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezja e punës dhe njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit I H i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.471.25 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.012.19€, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 135.13 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 1.012.19 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 291.55€, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e papaguara në shumë prej 1.012.19 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi I H, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 319.47 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

36. I B - PRN046-0438, PRN046-0434 dhe PRN046-0436

Kërkesa e ankuesit I B në lidhje me vendimin **PRN046-0438 për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0438, i datës 12.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 22 vite, e 07 muaj, e 04 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 436.50 €, apo shumës totale prej 1.746.00 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin

e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **873.00€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit I B në lidhje me vendimin **PRN046-0434 për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002- mars 2003, janar-mars dhe dhjetor 2004, janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0434 i datës 20.01.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezat e punës dhe njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit I H i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 2.042.65 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar

ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.404.63€, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 187.64 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 813.55 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 403.44€. Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 1.012.19 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi I B, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa e ankuesit I B në lidhje me vendimin **PRN046-0436, për tre paga të papaguara**, refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0436, i datës 12.02.2014.

Gjykata vendosi si në pikën e 36 të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar dhe e ka vërtetuar vendimin e kundërshtuar të AL, PRN046-0436 të datës 12.02.2014. Gjykata e refuzoi ankesën e ankuesit për tri pagat e fundit të pa paguara pasi që vlerësoi se këto paga i janë njohur ankuesit me ndryshimin e vendimit PRN046-0434, të datës 20.01.2014. Ankuesit marrëdhënia e punës i është ndërprerë në Mars të vitit 2006, ndërsa periudha për të cilën i janë njohur pagat si në pikën 36 të dispozitivit të këtij aktgjykimi është mars 2003, janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 dhe janar-mars 2005, që do të thotë se janë të përfshira edhe pagat e kërkuara me vendimin PRN046-0436.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 315.06 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

37. M Sh - PRN046-0369, PRN046-0367 dhe PRN046-0368

Kërkesa e ankuesit M Sh në lidhje me vendimin **PRN046-0369, për tre paga të papaguara**, aprovet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0369, i datës 10.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor, ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 181 dhe nr. i amzës 403, për tre paga 840.87 € (280.29 x 3 =840.87).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 840.87 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 181 dhe nr. i amzës 403, për tre paga në shumë prej 840.87 € (280.29 x 3 =840.87).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kësisoj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kësisoj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kësisoj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi M Sh, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit M Sh në lidhje me vendimin **PRN046-0367 për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0367, i datës 10.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006

dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 19 vite, e 03 muaj, e 29 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të tre pagave mujore në lartësi prej 280.29 €, apo shumës totale prej 840.87 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iii) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 10 deri në 19 vjet stazh, e ka përcaktuar në tre paga mujore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit M Sh në lidhje me vendimin **PRN046-0368 për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002- mars 2003, janar-mars dhe dhjetor 2004, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0368, i datës 10.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga libreza e punës dhe njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e

datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit M Sh i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.326.78 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 649.73€, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 121.85 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 527.88 €. Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 649.73 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP. Gjukata konstaton se në listën e pagave të punëtorëve në emër të pagave, ankuesit i janë njohur pagat për muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2005, mirëpo Gjukata me rastin vendosjes, në pajtim me nenin 76.3 të Ligjit për DHPGJS lidhur me nenin 2.1 të Ligjit për procedurën kontestimore vendosi në suaza të kërkesës kreditore të ankuesit.

Gjukata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjukata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi M Sh, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjukata e aprovon shumën në lartësi prej 233.14 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

38. M H - PRN046-0423

Kërkesa e ankuesit M H në lidhje me vendimin **PRN046-0423 për paga të papaguara**, për periudhën dhjetor 2002- mars 2003, janar-mars dhe dhjetor 2004, janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0423, i datës 12.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezat e punës dhe njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit M H i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.663.94 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.144.53€, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 152.83€ ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 662.4 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, dhe mars 2005 në shumë prej 329.3 €. Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e papaguara në shumë prej 1.144.53 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë

dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi M H kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 114.45 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

39. N B - PRN046-0541, PRN046-0543 dhe PRN046-0542

Kërkesa e ankuesit N B në lidhje me vendimin **PRN046-0541, për tre paga të papaguara**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0541, i datës 10.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Libreza e Punës dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë

kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor, ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 202 dhe nr. i amzës 76, për tre paga 1.094.99 € ($365.00 \times 3 = 1.094.99$).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.094.99 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 202 dhe nr. i amzës 76, për tre paga në shumë prej 1.094.99 € ($365 \times 3 = 1.094.99$).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi N B kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit N B në lidhje me vendimin **PRN046-0543, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0543, i datës 05.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga librezja e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 21 vite, e 04 muaj, e 34 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 365.00 €, apo shumës totale prej 1.460.00€, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **730.00€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit N B në lidhje me vendimin **PRN046-0542 për paga të papaguara**, për periudhën kohore dhjetor 2002-mars 2003, janar-mars dhe dhjetor 2004, dhe janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0542, i datës 05.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit N B i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.714.94 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.179.54 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 157.52 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej

682.74 €, dhe per vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 339.28 €, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 1.179.54 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe per muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi N B kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 373.45 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

40. N M K- PRN046-0691, PRN046-0688 dhe PRN046-0689

Kërkesa e ankueses N M K në lidhje me vendimin **PRN046-0691, për tre paga të papaguara**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0691, i datës 24.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtoret në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Vërtetimi mbi Përvojën e Punës, dhe nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimit të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor, ku emri i ankueses në listë është i radhitur me nr. Rend 219 dhe nr. i amzës 384, për tre paga 870.45 € ($290.15.00 \times 3 = 870.45$).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesja ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 870.45 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 219 dhe nr. i amzës 384, për tre paga në shumë prej 870.45 € ($290.15 \times 3 = 870.45$).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund të atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund të ketë duhet të parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesja N M K, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankueses N M K në lidhje me vendimin **PRN046-0688, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0688, i datës 24.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Vërtetimin mbi Përvojën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Lista e 20% e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesja kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 20.37 vite, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Vërtetimin mbi Përvojën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesja ka qenë punëto e NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankueses ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 290.15 €, apo shumës totale prej 1.160.6€, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv)

dëshmëpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **580.3€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesja ishte një punëtore e NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankueses N M K në lidhje me vendimin **PRN046-0689 për paga të papaguara**, për periudhën kohore dhjetor 2002-mars 2003, janar-mars dhe dhjetor 2004, dhe janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0689, i datës 24.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesja ishte një punëtore e NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankueses për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankueses duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesja nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesja, bazën e kërkesës së saj e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, dhe si dhe në pohimet e saj të parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtore N M K i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.371.95 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesja nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 944.01 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 126.00 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 545.9 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 272.11€, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 944.01 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesja N M K, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 297.50 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

41. R R - PRN046-0389, PRN046-0387 dhe PRN046-0388

Kërkesa e ankuesit R R në lidhje me vendimin **PRN046-0389, për tre paga të papaguara**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0389, i datës 10.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrës të tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është

parapara që kërkesat e tilla punëtoret në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 253 dhe nr. i amzës 553, për tre paga 982.76 € ($327.59 \times 3 = 982.76$).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 982.76 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 253 dhe nr. i amzës 553, për tre paga në shumë prej 982.76 € ($327.59 \times 3 = 982.76$).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kësisoj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kësisoj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kësisoj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të

parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi R R, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit R R në lidhje me vendimin **PRN046-0387, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0387, i datës 10.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashtruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga lista e 20% e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 6.33 vite, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të dy pagave mujore në lartësi prej 327.59 €, apo shumës totale prej 655.18€, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (ii)

dëmshtëpërblimin për raste të tilla për stazh prej 5 deri në 9 vjet stazh, e ka përcaktuar në dy paga mujore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit R R në lidhje me vendimin **PRN046-0388 për paga të papaguara**, për periudhën kohore dhjetor 2002-mars 2003, janar-mars dhe dhjetor 2004, dhe janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0388, i datës 10.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, listën e 20%, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit R R i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.413.12 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave të lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 989.19 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 124.83 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 558.76 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 305.6 €, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e papaguara në shumë prej 989.19 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt

të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi R R, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 262.71 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

42.S B - PRN046-0889, dhe PRN046-0890

Kërkesa e ankuesit S B në lidhje me vendimin **PRN046-0889, për tre paga të papaguara**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0889, i datës 19.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrës të tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat

përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 265 dhe nr. i amzës 394, për tre paga 1.263.08 € ($421.03 \times 3 = 1.263.08$).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.263.08 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 265 dhe nr. i amzës 394, për tre paga në shumë prej 1.263.08 € ($421.03 \times 3 = 1.263.08$).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kësisoj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kësisoj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kësisoj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi S B, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit S B në lidhje me vendimin **PRN046-0890, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0890, i datës 19.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 19 vite, e 07 muaj, e 19 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Libreza e Punës dhe Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të tre pagave mujore në lartësi prej 421.03 €, apo shumës totale prej 1.263.09€, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iii) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 10 deri në 19 vjet stazh, e ka përcaktuar në dy tri mujore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 252.61 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

42. T L - PRN046-0877, dhe PRN046-0875

Kërkesa e ankuesit T L në lidhje me vendimin **PRN046-0877, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0877, i datës 19.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga librezja e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 20 vite, e 07 muaj e 19 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 368.62 €, apo shumës totale prej 1.474.48€, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 10 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **737.24€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit T L në lidhje me vendimin **PRN046-0875 për paga të papaguara**, për periudhën kohore dhjetor 2002 deri në mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0875, i datës 19.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, listën e 20%, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezja e punës dhe njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit T Li ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.731.69 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën

dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.191.03 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 159.07 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 689.41 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 342.55 €. Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 1.191.03 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi Tefik Latifi, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 266.55€ në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

43.Xh K - PRN046-0697, PRN046-0695 dhe PRN046-0696

Kërkesa e ankuesit Xh K në lidhje me vendimin **PRN046-0697, për tre paga të papaguara**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0697, i datës 24.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre

paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimit të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 313 dhe nr. i amzës 144, për tre paga 876.48 € (292.16 x 3 =876.48).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 876.48 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 313 dhe nr. i amzës 144, për tre paga në shumë prej 876.48 € (292.16 x 3 =876.48).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së

likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi Xh K, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit Xh K në lidhje me vendimin **PRN046-0695, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0695, i datës 24.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezen e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 21 vite, e 10 muaj, e 21 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Libreza e Punës dhe Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 292.16 €, apo shumës totale prej 1.168.64€, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **584.32€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit Xh K në lidhje me vendimin **PRN046-0696 për paga të papaguara**, për periudhën kohore dhjetor 2002-mars 2003, janar-mars dhe dhjetor 2004, dhe janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0696, i datës 24.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, listën e 20%, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezja e punës dhe njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit Xh K i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.381.27 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e

lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 950.41 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 126.86 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 549.62 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 273.93 €, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 950.41 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi Xh K, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 299.55€ në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

43. **Xh S - PRN046-0898, dhe PRN046-0143**

Kërkesa e ankuesit Xh S në lidhje me vendimin **PRN046-0898, për tre paga të papaguara**, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0898 i datës 19.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 319 dhe nr. i amzës 357, për tre paga 1.089.40 € ($363.13 \times 3 = 1.089.40$).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.089.40 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankuesit në liste është i radhitur me nr. Rend 319 dhe nr. i amzës 357, për tre paga në shumë prej 1.089.40 € ($363.13 \times 3 = 1.089.40$).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006

ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrorë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund të atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrorë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi Xh S, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit Xh S në lidhje me vendimin **PRN046-0143, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0143, i datës 22.01.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashtruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezen e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 19 vite, e 07 muaj, e 19 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Libreza e Punës dhe Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk

ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të tre pagave mujore në lartësi prej 363.13 €, apo shumës totale prej 1.089.39€, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iii) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 10 deri në 19 vjet stazh, e ka përcaktuar në tri paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **1.089.39€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në tre (3) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iii), e në kuptim të kompensimit i takojnë tre (3) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (10 gjer 19 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 217.87€ në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

44. Z D - PRN046-0577, PRN046-0575 dhe PRN046-0573

Kërkesa e ankueses Z D në lidhje me vendimin **PRN046-0577, për tre paga të papaguara**, aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0577 i datës 10.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga për periudhën Janar 2006 - Mars 2006, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit

Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankueses në listë është i radhitur me nr. Rend 323 dhe nr. i amzës 290, për tre paga 874.84 € (291.61 x 3 =874.84).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 874.84 €, gjykata është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, ku emri i ankueses në liste është i radhitur me nr. Rend 323 dhe nr. i amzës 290, për tre paga në shumë prej 874.84 € (291.61 x 3 =874.84).

Ndërsa pjesën prej 25.16 euro gjykata e refuzon pasi që në listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, figuron shuma prej 874.84 euro, e jo siç kërkon ankuesi shumen prej 900.00 euro. Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për lartësinë e pagave të cilat i kërkon.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur

pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kësaj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrorë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi Z D, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankueses Z D në lidhje me vendimin **PRN046-0575, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0575, i datës 10.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 21 vite, e 05 muaj, e 22 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Libreza e Punës dhe Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 291.61 €, apo shumës totale prej 1.166.44€, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata

është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **874.82€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesja ishte një punëtoare e NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankueses Z D në lidhje me vendimin **PRN046-0573 për paga të papaguara**, për periudhën kohore dhjetor 2002-mars 2003, janar-mars dhe dhjetor 2004, dhe janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0573, i datës 10.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesja ishte një punëtoare e NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankueses për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankueses duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesja, bazën e kërkesës së saj e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, listën e 20%, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezja e punës dhe njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtoares Z D i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1.378.74 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005

dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 948.68 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 126.63 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 548.61 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 273.44€, Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 948.68 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesja Z D, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 298.99€ në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

45. B Z - PRN046-0646, PRN046-0650, dhe PRN046-0648

Kërkesa e ankuesit B Z në lidhje me vendimin **PRN046-0646**, për tre paga të papaguara, aprovohet si i bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0646, i datës 12.02.2014.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës dhe në parashtrësat tjera gjatë procedurës me shkrim se kërkesa e ankuesit për tre paga të fundit të papaguara, është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, Sipas gjykatës pretendimi i të paditurës nuk është i saktë, pasi që në këtë rast ky Ligj nuk mund

të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.1. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguara, të kufizuara në tre paga mujore të cilën ankuesi e ka kërkuar. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i N.Sh-së dhe se personat përgjegjës të N.SH si rezultat i privatizimi të në N.SH-së, kishin llogaritur pagesën e tre pagave për çdo punëtor , ku emri i ankuesit në listë është i radhitur me nr. Rend 48 dhe nr. i amzës 35 për tre paga 1.779.81 ($593.27 \times 3 = 1.779.81$).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe listën e pagave të punëtorëve të lëshuar me 31 mars 2006, e lëshuar nga personat përgjegjës të N.Sh-së, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.Sh. E paditura në përgjigjen e saj nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.Sh në periudhën e lartcekur, apo për ta demantuar atë listë me ndonjë provë se nuk i ka mbetur borxh 3 pagat për periudhën Janar - Mars 2006, ashtu siç përshkruhet në listë pagesën, lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së.

Gjykata me rastin e aprovimit të shumës prej **1.690.82Euro**, është bazuar në listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj, e dt. 31 mars 2006, si dhe në bazë të kërkeses kreditore të ankuesit.

Gjykata konstaton se në listën e pagave të punëtorëve figuron shuma prej 1.779.81€, ($593.27 \times 3 = 1.779.81$), euro, në emër të pagave, mirëpo Gjykata me rastin vendosjes, në pajtim me nenin 76.3 të Ligjit për DHPGJS lidhur me nenin 2.1 të Ligjit për procedurën kontestimore vendosi në suaza të kërkesës kreditore të ankuesit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera,

të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrorë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrorë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi B Z kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit B Z në lidhje me vendimin **PRN046-0650, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0650, i datës 10.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashtruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruar në ankesë. Nga lista e 20% e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 22 vite, e 65 muaj, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Libreza e Punës dhe Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruar në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk

ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 593.27 €, apo shumës totale prej 2.373.08€, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **1.186.54€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesja ishte një punëtorë e NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Kërkesa tjetër e ankuesit B Z në lidhje me vendimin **PRN046-0648 për paga të papaguara**, për periudhën kohore dhjetor 2002-mars 2003, janar-mars dhe dhjetor 2004, dhe janar-mars 2005, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0648, i datës 12.02.2014.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesja ishte një punëtorë e NSH FAN “Zahir Pajaziti”, Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në listën e pagave të mbetura borxh nga NSH-ja, pastaj me njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës, listën e 20%, dhe si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezja e punës dhe njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e rrogave e lëshuar nga personat përgjegjës të NSH-së e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH “Fan Zahir Pajaziti”, Podujevë, punëtorit B Z i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 2.020.88 €, për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars 2003, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave të papaguara për periudhën e lartcekur, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003, janar 2004 – mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar 2005 – mars 2005 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personat përgjegjës të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.165.77 €, gjykata është bazuar në listën e rrogave ashtu që për vitin 2003 i është njohur paga për muajin mars në shumë prej 252.79 € ndërsa për vitin 2004 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 në shumë prej 847.03 €, dhe për vitin 2005 i janë njohur pagat për muajin janar, shkurt dhe mars 2005 në shumë prej 65.95€. Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 1.165.77 € me përjashtim të pagave të papaguara për muajt dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, të cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKP.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se edhe për periudhën mars 2003 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi B Z kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 522.96€ në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

46. S M - PRN046-0172

Kërkesa e ankuesit S M në lidhje me vendimin **PRN046-0172, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0172, i datës 22.01.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga librezja e punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 21 vite, e 10 muaj, e 21 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Libreza e Punës dhe Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 369.56 €, apo shumës totale prej 1.478.24€, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **739.12€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kësisoj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kësisoj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kësisoj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të tij dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 147.82€ në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

47. A H - PRN046-0400

Kërkesa e ankuesit A H në lidhje me vendimin **PRN046-0400 për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës**, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL nr. PRN046-0400, i datës 12.02.2014.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se kërkesa e ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e pasafatshme – është parashkruar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në: Librezën e Punës, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga AKM datë 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006 dhe Listën përfundimtare të Punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave nga privatizimi i NSH-së (Lista e 20 %) si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga librezja e punës, e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN “Zahir Pajaziti” apo stazh pune prej 22 vite, e 04 muaj, e 21 ditë, e cila nuk kontestohet nga e paditura.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante: Librezja e Punës dhe Njoftimin për Përfundimin e Punësimit të datës 24 mars 2006, Listën e pagave të mbetur borxh të datës 24.03.2006, Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006, listën e 20%, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të katër pagave mujore në lartësi prej 297.95 €, apo shumës totale prej 1.191.8€, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe Listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj datë 31 mars 2006. Për më tepër, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, ligj në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, e cila në kuptim të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv) dëmshpërblimin për raste të tilla për stazh prej 20 deri në 29 vjet stazh, e ka përcaktuar në katër paga mujore.

Pjesën e mbetur, prej **595.9€** gjykata e refuzon për arsye, sepse siç edhe u cek më lartë, ankuesit i takon e drejta vetëm në katër (4) paga të papaguara, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27, të nenit 12.2 pikat (dh) dhe (iv), e në kuptim të kompensimit i takojnë katër (4) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjashtë (6) paga, e po ashtu edhe lartësia e pagave të cilat i kërkon.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj

pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështoj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështoj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështoj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të tij dhe kështoj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 119.18€ në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e paditura AKP si palë e pasuksesshme, obligohet ti paguaj ankuesit shpenzimet e procedurës.

OBLIGOHET e paditura AKP, që përfaqësuesit të ankuesve të i'a paguaj shpenzimet e përfaqësimit në bazë të rregullores së tarifës së Odës së Avokatëve të Kosoves në shumë prej 680.00 euro, ashtu që për hartimin e padisë në shumë prej 650€, si dhe për taksën gjyqësore në shumë prej 30.00€, ndërsa pjesën e mbetur prej 650.00€ për përfaqësim pranë AL-së, refuzohet me arsyetim se përfaqësuesit në rastin konkret mund ti gjykohen vetëm për shpenzimet pranë

gjykatës, e jo edhe pranë AL-së. Lidhur me shikimin e shkresave përfaqësuesi nuk ka bere një veprim të tillë.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtare

Hajrie Shala,